



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR  
KRYETARI

Nr. 6125 prot.

Ballsh, më 14.12 2023

PROJEKT - VENDIM

Nr. 41 Datë 14/12/2023

**“PËR  
MIRATIMIN E NIVELIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE, FUNKSIONARËVE TË  
ZGJEDHUR DHE TË EMËRUAR TË BASHKISË  
MALLAKASTËR, INSTITUCIONEVE NË VARËSI, FUNKSIONEVE TË  
TRANSFERUARA DHE TË DELEGUARA PËR VITIN 2024”**

Në zbatim të Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 54 “Detyrat dhe kompetencat e Këshillit Bashkiak”, gërma ç), Ligjit nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo – territoriale të njësive të qeverisjes vendore” Ligjit nr.9936,datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar, Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”; i ndryshuar, Ligjit nr. 152/2013 “Për nënpunësin civil”, i ndryshuar, Ligjit nr.35/2023,datë 29.05.2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave,trajttimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarëve në Institucionet e Administratës Publike, VKM nr. 328, datë 31.05.2023 “Për klasifikimin e funksioneve, për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nënpunësve civil e të punonjësve administrativ të njësive të vetëqeverisjes vendore”, VKM-s nr. 175, datë 08.03.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në arsimin parauniversitar”, i ndryshuar me VKM Nr.241,datë 20.04.2023,VKM nr.350 ,datë 19.04.2017 “Për trajtimin me page dhe shtesa mbi page të punonjësve shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, ndryshuar me Vkm nr.240, datë 20.04.2023, Vendimit Nr.326,datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteve të ndryshme në disa Institucione të Administratës Publike,VKM nr.325,datë 31.05.2023 “Për miratimin e Strukturës së pagave,niveleve të pagave dhe shtesave të tjera të nëpunësve në disa Institucione të Administratës Publike,

**- KËSHILLIT TË BASHKISË**

**PROPOZOJ:**

- I. Miratimin e nivelit të pagave të punonjësve,funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar të Bashkisë Mallakastër, të institucioneve në varësi,funksioneve të transferuara dhe të delegura për vitin 2024 sipas lidhjes nr.1,2,3,4,5,6,7,8,9, pjesë përbërse e këtij projektvendimi.

- II. Miratimin e shkallës së vështirësisë dhe dëmshmërisë për pozicionet e punës (Manovrator, Skrepist, Shofer Kamioni, Shofer mjeti teknologjik) sipas lidhjes bashkalidhur.
- III. Miratimin e shpërblimit mujor të anëtarëve të këshillit bashkiak në masën 10% e pagës së Kryetarit të Bashkisë.
- IV. Miratimin e shpërblimit mujor të kryetarëve të fshatrave në masën 8% e pagës së Kryetarit të Bashkisë.
- V. Efektet financiare do të fillojnë nga data 01.01.2024.

**KRYETAR**

**Qerim Ismailaj**

